

Vendim nr. 295 datë 03.12.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Marjana Semini, Anëtare

në datën 03.12.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (Gj) 2024 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

KËRKUES: GJON SHKAMBI

OBJEKTI: Konstatimi i shkeljes së neneve 451/a e 523 të Kodit të Procedurës Civile dhe neneve 41 e 42, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi parashton se është pronar i një sipërfaqeje të fituar me vendim të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (*KKKP*). Sipas tij, kjo sipërfaqe ka qenë pjesërisht e zënë me objekte, si dhe pjesërisht e lirë dhe në lidhje me të, bazuar në parashikimet ligjore në fuqi, ka ushtruar pa pengesë të drejtën e parablerjes.

2. Në kushtet kur vendimi i KKKP-së kishte pasaktësi, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesëpadi për saktësimin e tij. Me vendimin nr. 119, datë 11.02.2002, kjo gjykatë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, duke saktësuar vendimin e KKKP-së. Në vijim, me vendimin nr. 20, datë 28.06.2010, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

3. Në kushtet kur objekti në sipërfaqen e pronës së kërkuesit, konkretisht ish-Shkolla e Rezervave, Shkodër, ishte zënë nga posedues të paligjshëm, ai u është drejtuar disa zyrave përmbareme për ekzekutimin e vendimit gjyqësor. Bazuar në kërkesën e kërkuesit dhe vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër, me shkresën nr. 116 dkp., regj. 2158, datë 13.10.2022, Zyra e Përmbaremit Shkodër u është drejtuar 32 individëve, të cilët qëndronin forcërisht dhe në kundërshtim me ligjin në pasurinë e kërkuesit, për lirim të banesave dhe ekzekutimin vullnetar të titullit ekzekutiv, ndërsa me shkresën nr. 116 dkp., regj. 2616, datë 31.10.2022, zyra e përmbaremit ka vendosur fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm të këtij titulli.

4. Veprimet e zyrës përmbareme janë kundërshtuar gjyqësisht nga shtetasit Gj.S., N.P., N.N. dhe M.C., të cilët në datën 21.10.2022 i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesëpadi, duke kërkuar edhe pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv. Në lidhje me tre të parët, me vendimin nr. 784 (4921), datë 24.11.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke vlerësuar se ajo ishte paraqitur jashtë afatit 5-ditor të parashikuar nga neni 610, paragrafi i parë, i Kodit të Procedurës Civile (KPC). Po sipas gjykatës, pretendimet e paditësve se bëhej fjalë për gjë të gjykuar ishin të pabazuara, pasi vendimet për të cilat ata pretendonin cenim të këtij parimi ishin shfuqizuar. Nga ana tjetër, pretendimet se nuk kishin qenë palë në gjykimet e mëparshme të zhvilluara në lidhje me pasurinë ishin të pabazuara, pasi prona posedohej prej tyre në mënyrë të kundërligjshme. Ndërsa në lidhje me kërkesëpadinë e shtetasit M.C., me vendimin nr. 1669 (1545), datë 31.03.2023, kjo gjykatë ka vendosur kthimin e saj si rrjedhojë e mosplotësimit të të metave.

5. Po kështu, shtetasit Gj.S., N.P. dhe N.N. i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me kërkesëpadi për sigurimin e padisë dhe për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv. Me vendimin nr. 38 (5086), datë 08.12.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur pushimin e gjykimit, duke vlerësuar se, sipas parashikimeve të nenit 202 të KPC-së, kërkesa për sigurimin e padisë nuk mund të ngrihej në fazën e ekzekutimit të vendimit. Në këto kushte, kërkesëpadi ishte e pabazuar në ligj. Nga ana tjetër, shtetasit M.Th, D.L., Gj.M., S.V., P.P., S.B., R.K., M.P., S.L. dhe P.Rr. kanë paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor

Shkodër, duke kërkuar pushimin e ekzekutimit të lajmërimit për ekzekutim vullnetar të titullit ekzekutiv. Me vendimin nr. 157 (1458), datë 27.03.2023, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur pushimin e gjykimit, me arsyetimin se neni 617 i KPC-së i njihte vetëm përmbauesit gjyqësor të drejtën për të kërkuar pushimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv.

6. Në datën 24.10.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuetit

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

7.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi, pavarësisht detyrimit të përcaktuar në nenin 523 të KPC-së për të mbështetur përmbauesin gjyqësor gjatë procedurës së ekzekutimit, Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër ka refuzuar të mbështesë Zyrën e Përmbaimit Shkodër, me pretendimin se nuk ekziston asnjë urdhër ekzekutiv që përcakton detyrime për personat e tretë posedues të paligjshëm në pronën e tij, në kundërshtim me vendimin e formës së prerë të gjykatës dhe nenin 451/a të KPC-së. Kjo drejtori ka marrë përsipër kryerjen e vlerësimit të veprimeve përmbaimore dhe interpretimin e vendimit të gjykatës, titull ekzekutiv, ndonëse është bërë me dije nga zyra përmbaimore për parashikimet e nenit 603 të KPC-së.

7.2. *E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi prej vitesh kërkuesi është në pamundësi të gëzimit dhe posedimit të pronës, si rrjedhojë e posedimit të paligjshëm të saj nga persona të tjerë.

7.3. *E drejta për jetë private*, pasi, si rrjedhojë e mosmarrjes së masave nga autoritetet shtetërore, atij dhe familjes së tij u janë shkaktuar dëme të mëdha psikologjike.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuetit*

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për

gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

9. Në rastin konkret, Kolegji vëren se, ndonëse në objekt të ankimit kushtetues individual kërkuesi ka kërkuar konstatimin e shkeljes së neneve 451, shkronja “a” e 523 të KPC-së dhe neneve 41 e 42, pika 1, të Kushtetutës, në thelb, ai kërkon konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit nr. 20, datë 28.06.2010 të Gjykatës së Apelit Shkodër, titull ekzekutiv, për shkak të mosndërhyrjes së Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër në kuadër të detyrimit të përcaktuar në nenin 523 të KPC-së. Në këtë këndvështrim, Kolegji vlerëson se, si individ, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, titull ekzekutiv, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individit pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Duke qenë se mjete juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (*shih vendimet nr. 39, datë 14.05.2024; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Kolegji vëren se mosekzekutimi në kohë i vendimeve gjyqësore të formës së prerë është trajtuar më parë në jurisprudencën e Gjykatës si rrjedhojë e mungesës së mjeteve ligjore në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 6, datë 23.02.2016; nr. 14, datë 30.03.2015; nr. 9, datë 27.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Me ndryshimet që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017

“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, të cilat kanë hyrë në fuqi më 05.11.2017, ligji procedural ka parashikuar tashmë mjete ligjore efektive, nëpërmjet të cilave individit i garantohet mbrojtja në rastet e cenimit të së drejtës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, brenda afatit të arsyeshëm. Në referim të këtyre ndryshimeve ligjore, neni 399/2 i KPC-së ka përcaktuar se afat i arsyeshëm i përfundimit të ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë do të konsiderohet afati 1-vjeçar, i cili fillon nga dita e paraqitjes së kërkesës për ekzekutim, ndërsa sipas nenit 399/6 të KPC-së, në rastet kur çështja, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është në procedurë ekzekutimi, kërkesa gjykohet nga gjykata e shkallës së parë, kompetente për ekzekutimin, sipas rregullave në fuqi.

12. Kolegji sjell në vëmendje, gjithashtu, se ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, i ndryshuar, përcakton përgjegjësinë e këtyre organeve për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara interesave të personave privatë në ushtrim të funksioneve të tyre publike, përfshirë edhe rastet kur shkak i dëmit janë mosveprimet e kundërligjshme të organit shtetëror.

13. Në këndvështrim të këtyre parashikimeve ligjore, në rastin konkret, Kolegji vlerëson se Gjykata nuk mund të investohet për shqyrtimin e kërkesës së kërkuarit për konstatimin e cenimit të së drejtës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerës, pasi legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike që i ofrojnë rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Për rrjedhojë, ai duhet t’u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues.

14. Në këndvështrim të sa më lart, Kolegji çmon se kërkuari nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t’i drejtohet Gjykatës, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, për rrjedhojë kërkesa e tij nuk mund të merret në shqyrtim.

15. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.